Pra asnjë nga antaret e bashkimit të operatorëve ekonomikë **Kacdedja Shpk dhe Agri Construction Shpk** nuk plotëson kërkesën kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit për materiale Tubo PVC,Tubo PP,Tubo PE,Tubo dhe rakorderi PP-R në kundërshtim të nenit 14 , nenin 30 nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrveshjes së

bashkëpunimit për zbatimin e kontratës.

Përcaktuar shprehimisht:

“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”, si dhe në dokumentat e tenderit, Seksioni 4 Procedura, pika 4.6 është përcaktuar shprehimisht:

“Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip	X	Anglisht
Tjetër	_____	

Përcaktuar shprehimisht:

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

6. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.5, germës f,** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi për sa i përket kapaciteteve ne mjete dhe paisje teknike duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Fabrike prodhim betoni Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

Për fabrikën e prodhimit të betonit në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III 1 B lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat te vlefshme per realizimin e kontrates objekt prokurimi, QKL, planimetri dhe dokumentacion dhe verteton pronesine e fabrikes. Ajo duhet të jetë jo më larg se 60 km nga sheshi i ndertimit ,për të siguruar një cilësi sa më të lartë të specifikuar në markat e betonit.)

Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Kacdedja Shpk dhe Agri Construction Shpk**,për sa i përket fabrikës së prodhimit të betonit të deklaruar nga operatori ekonomik **Kacdedja Shpk**, për të cilën ka lidhur kontratë furnizimi me shoqërinë "F....." shpk , nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk e përmbush kriterin e vendosur në dokumentat standarte të tenderit konkretisht pikën **2.3.5,gërma f** , në lidhje me fabrikën e prodhimit të betonit **e cila duhet të jetë jo më larg se 60 km** nga sheshi i ndertimit ,sipas vendodhjes së objektit të kontratës përcaktuar në raportin teknik dhe seksioni 2.10 në dokumentat standarte të tenderit.

Nga krahasimi i vendodhjes së fabrikës me anë të cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë **Kacdedja Shpk dhe Agri Construction Shpk** do të furnizohet me beton dhe vendndodhjes së sheshit të ndertimit konkretisht "Shkolla e Mesme e Bashkuar "JANI VRETO", qyteti Leskovik rezulton të jetë 98.8 km nga 60 km që kërkohet,kjo referuar inventarit te rrjetit rrugor kombetar me detajet e nevojshme(distancë,gjerësi, etj) , të publikuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar . Nisur nga ky fakt dokumentacioni i paraqitur për fabrikën e prodhimit të betonit nuk plotëson kërkesën e vendosur në dokumentat standarte të tenderit.

Referuar nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës bashkimi i operatorëve ekonomikë **Kacdedja Shpk dhe Agri Construction Shpk** nuk plotëson **pikën 2.3.5 germa f** kërkesë kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të 46, pika 1 nenit 53, pika 3 Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe neni 14,neni 66 ,neni 74 pika 2, pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe fakteve të mësipërme shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë për këtë procedurën e prokurimit e shpall **të pavlefshme** ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë **“Kacdedja Shpk” dhe “Agri Construction Shpk ”**, pasi nuk plotëson kërkesat kualifikuese të vendosura në dokumentat standarte të tenderit.

4.Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik **“Shendelli Shpk” K07924803N dhe “ Shkelqimi 07 Shpk ” K68121808W**

1. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3 germa a** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Operatori/et ekonomike pjesemarrës duhet te kene ne stafin drejtues minimumi :

- 1 (nje) inxhinier ndertimi;*
- 1 (një) inxhinier Topograf*
- 1 (nje) inxhinier hidroteknik;*
- 1 (nje) inxhinier mekanik;*
- 1 (nje) inxhinier elektrik;*
- 1 (nje) inxhinier mjedisi*

*Inxhinieret e sipercituar duhet te figurojne si drejtues teknik ne licensen e operatorit ekonomik ofertues dhe ne listepagesen e shoqerise per periudhen **Janar 2018-Qershor 2018** .*

Per secilin duhet te paraqiten:

- Kontrate pune e noterizuar*
- Diploma*
- CV-te*

***Per inxhinierin mekanik** te paraqitet certifikate si ekspert per auditim energjie,(i pajisur me “Certifikate per auditimin e energjise).*

***Per inxhinierin e mjedisit** te paraqitet certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk** ,rezultoi se asnjë nga operatorët ekonomik,nuk ka dorëzuar për inxhinierin.mekanik certifikatë per auditimin e energjisë, operatori ekonomik **Shkelqimi 07 Shpk** për inxhinierin.mekanik mungon diploma, duke mos plotësuar kërkesën kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit, në kundërshtim të nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës.

2. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3 germa b** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Operatori/et ekonomike duhet te kene ne stafin e tyre personel te kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (nje) Ekspert zjarrfikës te certifikuar*
- 1 (nje) inxhinier ndertimi profil strukturist*
- 1 (nje) inxhinier elektronik*

- 1 (nje) arkitekt;

Per secilin duhet te paraqiten:

- Kontrate pune e vlefshme (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit),
- Diploma,
- CV-te

Secili prej tyre duhet te figuroje ne listepagesen e shoqerise per periudhen **Janar 2018-Qershor 2018**. (Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike ky kriter plotesohet nga secili anetar i bashkimit).

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**, rezultoi se asnjë nga operatorët ekonomik, nuk ka dorëzuar dokumentacion për 1(nje) inxhinier elektronik, mungon diploma për *inxhinier elektronik*, operatori ekonomik **Shendelli Shpk** ka paraqitur vetem diplome të maturës shtetërore, duke mos plotësuar kërkesën kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit, në kundërshtim të nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës.

3. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3 germa c** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt per gjate gjithë afatit te zbatimit te objektit te kontrates dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

Per te cilin te paraqiten:

- Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- Diploma
- CV

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**, rezultoi se operatori ekonomik **Shendelli Shpk**, ne deklaratën për drejtuesit teknik nuk është percaktuar fakti nëse drejtuesit teknik janë të angazhuar ne kontrata te tjera të lidhura nga ana e operatorit ekonomik.

Pra sa me siper cituar deklarata per drejtuesit teknik nuk eshte e sakte dhe e plote pasi nga ana e shoqërisë nuk është deklaruar fakti nese drejtuesit teknik janë të angazhuar apo jo ne kontrata te tjera, gjithashtu edhe operatori ekonomik **Shkelqimi 07 Shpk**, nuk ka dorëzuar deklaratë dhe dokumentacion për drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt, duke mos plotësuar kërkesën kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit, në kundërshtim të nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës.

4. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3 germa d** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr: 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar me VKM Nr: 742, datë 6.11.2003 Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë”

Per te cilin te paraqiten:

- Kontrate pune e vlefshme
- Diplomë
- Urdher Mjeku

• Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Janar 2018-Qershor 2018**.
(Ne rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje, në mbështetje të legjislacionit të sipërcituar).

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**, rezultoi se operatori ekonomik **Shkelqimi 07 shpk**, nuk ka dorëzuar dokumentacion për mjekun, duke mos plotësuar kërkesën kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit, në kundërshtim të nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrëveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës.

5. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3 germa g** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Operatori/et ekonomikë ofertues duhet të ketë në stafin e tij minimumi 1 (nje) inxhinier ndertimi dhe 2 (dy) punonjes te trajnuar dhe te kualifikuar per punime ne lartesi, nder te cilet njeri te jete me detyre saldator leshuar nga nje organizem certifikimi i pavarur i njohur nga sistemet e standartizimit kombetar ose nderkombetar dhe i regjistruar prane drejtorise se akreditimit ne ME ne RSH-se ne menyre qe te kuptojne dhe te ndjekin procedurat e punimeve. Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Janar 2018-Qershor 2018**.*

Per secilin duhet te paraqiten:

- *Kontrate e punes*
- *Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trup certifikuese e akredituar ne RSH-se.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**, rezultoi se operatori ekonomik **Shendelli Shpk**, nuk ka dorëzuar dokumentacion për 1(nje) inxhinier ndertimi dhe 1(nje) punonjes te trajnuar dhe te kualifikuar per punime ne lartesi, gjithashtu edhe operatori ekonomik **Shkelqimi 07 Shpk**, nuk ka dorëzuar dokumentacion kualifikues për stafin e punonjesve konkretisht 1 (nje) inxhinier ndertimi dhe 2 (dy) punonjes te trajnuar dhe te kualifikuar per punime ne lartesi, nder te cilet njeri te jete me detyre saldator , duke mos plotësuar kërkesën kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit, në kundërshtim të nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrëveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës.

6. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3 germa f** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Operatori/et ekonomikë duhet te kenë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për periudhën **Janar 2018-Qershor 2018** të pakten 30(Tridhjetë) punonjes te kualifikuar me Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga ISHTI, ose nga nje trup certifikuese e akredituar ne RSH-se, nga te cilet te jene:*

<i>Ing.Ndertimi</i>	<i>(1 person)</i>
<i>Hekurthyes</i>	<i>(1 person)</i>
<i>Saldator</i>	<i>(2 persona)</i>
<i>Elektracist</i>	<i>(3 persona)</i>
<i>Teknik 2 /specialist 2/ Punetore 2 ndertimi</i>	<i>(6 persona)</i>
<i>Hidraulik</i>	<i>(3 persona)</i>
<i>Mekanik</i>	<i>(2 persona)</i>

<i>Shtrues pllakash</i>	<i>(3 persona)</i>
<i>Bojaxhi</i>	<i>(3 persona)</i>
<i>Manovratore(3 automakinistë, 2eskavatoristë, 1 autovincier)</i>	<i>(6 persona)</i>

Per secilin duhet te paraqiten:

- *Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)*
- *Deshmi Kualifikimi te Sigurimit Teknik e leshuar nga nje trup çertifikuese e akredituar ne RSH-se*

Per manovratoret te paraqitet edhe deshmia e aftesise profesionale per perdoruesit e makinerive te renda te ndertimit dhe punimeve ne toke e leshuar nga DPSHTRR dhe leja e drejtimit ku te disponohet minimumi kategoria C.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**, rezultoi se operatori ekonomik **Shkelqimi 07 shpk**, nuk ka dorëzuar dokumentacion kualifikues për stafin e punonjesve, Shtrues pllakash, Bojaxhi, mungojnë kontratat e punës për punonjesit e deklaruar Saldator, Elektricitist, Teknik ,specialist ,Punetore ndertimi , Hidraulik, Mekanik, gjithashtu për manovratorët mungojnë deshmia e aftesise profesionale, duke mos plotësuar kërkesën kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit, në kundërshtim të nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës.

7. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.4 germa a,b,c,d,e** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

a. Operatori/et ekonomik duhet te paraqesin:

- *ISO 9001:2008/2015 (e vlefshme) (ose ekuivalente)*
- *OHSAS 18001-2007(e vlefshme) (ose ekuivalente)*
- *ISO 14001-2004/2015 (e vlefshme) (ose ekuivalente)*
- *PAS 99-2012 (e vlefshme) (ose ekuivalente)*
- *ISO 1452-1:2009 (e vlefshme) (ose ekuivalente)*
- *ISO/IEC 27001 -2013 (e vlefshme) (ose ekuivalente)*
- *ISO 50001 -2011 (e vlefshme) (ose ekuivalente)*
- *ISO 28001:2007 (e vlefshme) (ose ekuivalente)*
- *EN ISO 3834-2:2006 (e vlefshme) (ose ekuivalente)*

Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese keto certifikata. (ose ekuivalente) , në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**, rezultoi se operatori ekonomik **Shkelqimi 07 shpk**, nuk ka dorëzuar certifikatat ISO 1452-1:2009 (e vlefshme) (ose ekuivalente) dhe ISO 28001:2007 (e vlefshme) (ose ekuivalente), duke mos plotësuar kërkesën kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit, në kundërshtim të nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës.

8. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.4 germa b,c,d,e** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

a. Operatori/et ekonomik duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin certifikate ISO 9001:2008/2015, (ose ekuivalente) per prodhimin, nese eshte prodhues i materialeve qe do perdoren ne ndertimin e objektit ku mimimalisht te perfshihen:

- Kollë
- Pllaka
- Llaçra
- Polisterol
- Kartonxhes

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertuesit -distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**, konkretisht operatori ekonomik **Shendelli Shpk**, për kontratën e furnizimit datë.06.08.2016 lidhur midis paleve shoqëria **D..... sh.a** dhe shoqëria **Shendelli Shpk** me objekt furnizim Llaçra, Tulla, Bojra, Inerte, Gips, Kartonxhes, Pllaka, Polisterol , rezultoi se nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar, pasi nuk ka dorëzuar certifikate **ISO 9001:2008/2015**, (ose ekuivalente) për materialet e ndërtimit Kollë, Pllaka, Llaçra, Polisterol, Kartonxhes, gjithashtu specifikimet teknike nuk janë në gjuhën shqipe, janë të papërkthyer dhe të panoterizuara për materialet e ndërtimit **Pllaka**, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësisë të specifikimeve teknike.

Çertifikata **ISO 9001:2008** e dorëzuar **nuk përputhet me kriterin e vendosur**, pasi fushëveprimi i saj është : Prodhim, importim dhe shitje të bojrave për industrinë e ndërtimit. Tregtim, importim dhe shpërndarje me shumicë e pakicë të aksesorëve, lëndëve të para e artikujve industriale për sektorin e mobilerisë dhe sektorin e bojrave në industrinë e ndërtimit, **duke mos plotësuar kërkesën e vendosur nga autoriteti kontraktor .**

b. Operatori/et ekonomik duhet te jene te pajisur dhe te paraqesin certifikate ISO 9001:2008 / 2015 (e vlefshme) (ose ekuivalente), per prodhimin, nese eshte prodhues i materialeve qe do perdoren ne ndertimin e objektit ku mimimalisht te perfshihen:

- *Dritare d/alumini plastike me dopio xham*
- *Ndricues fluoreshent 1x40w.IP65*
- *Ndricues fluoreshent 1x60w.IP65*
- *Ndricues FL-(2X36)W IP-40*
- *Ndricues fluoreshent 4x18w,IP40*
- *Ndricues evakuimi me llampe 1x11w;IP- 40*
- *KAMER 700TVL FOKUS 2.8-12MM 0LUX IR 24LED 12VDC OSD IP65*

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertuesit -distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.)

Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli**

Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk,konkretisht operatori ekonomik **Shendelli Shpk**, për kontratën e furnizimit datë.06.08.2016 lidhur midis paleve shoqëria **I A** dhe shoqëria **Shendelli Shpk** me objekt furnizim dyer dritare alumini, rezultoi se nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar,pasi specifikimet teknike nuk janë në gjuhën shqipe,janë të papërkthyer dhe të panoterizuara, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimit të specifikimeve teknike..

Për kontratën e furnizimit datë.09.08.2018 lidhur midis paleve shoqëria **S E shpk** dhe shoqëria **Shendelli Shpk** me objekt furnizim materiale elektrike të të gjitha llojeve, rezultoi se nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar,pasi certifikatat iso të dorëzuara nuk janë në gjuhën shqipe,janë të papërkthyer dhe të panoterizuara, duke e bërë të pamundur identifikimin,gjithashtu specifikimet teknike nuk janë në gjuhën shqipe,janë të papërkthyer dhe të panoterizuara, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimit të specifikimeve teknike..
Operatori ekonomik **Shendelli Shpk** nuk ka paraqitur dokumentacion plotësues të kërkesës për materiale KAMER 700TVL FOKUS 2.8-12MM 0LUX IR 24LED 12VDC OSD IP65 .

c.Operatori/et ekonomik në rastet kur nuk është prodhues duhet të paraqesë kontrate furnizimi nga prodhuesi/furnizuesi të noterizuar për bojën hidroplastike që do të perdoret në lysterjen e fasada e jashtme,tavanet, muret e brendshme. Prodhuesi/furnizuesi të ketë të përfshirë detyrimisht në objektin e ekstraktit të rregjistrimit tregetar dhe objektin për prodhim boje hidroplastike.

*(Operatori ekonomik të paraqesë Ekstrakt i Rregjistrimit Tregetar të Prodhuesit,analizat dhe specifikimet si dhe certifikatat **ISO 9001:2008/2015 (e vlefshme)(ose ekuivalente)/dhe ISO 14001-2004/2015 (e vlefshme) (ose ekuivalente)**. Boja është material baze për ndertimin e objektit të prokurimit.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**,konkretisht operatori ekonomik **Shendelli Shpk**, për kontratën e furnizimit datë.06.08.2016 lidhur midis paleve shoqëria **D..... sh.a** dhe shoqëria **Shendelli Shpk** me objekt furnizim Llaçra,Tulla,Bojra,Inerte,Gips, Kartonxhes,Pllaka, Polisterol , rezultoi se nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar,pasi nuk ka dorëzuar certifikate **ISO 14001-2004/2015 (e vlefshme) (ose ekuivalente)** për prodhim boje hidroplastike .

*d. Operatori/et ekonomik duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin certifikate **ISO 9001:2008/2015, ISO 14001:2004, OHSAS 18001:2007 (e vlefshme)**, (ose ekuivalente), për prodhimin nëse është prodhues i materialeve që do të perdoren në ndertimin e objektit ku minimalisht të përfshihen:*

- *Tubo PVC*
- *Tubo PP*
- *Tubo PE*
- *Tubo dhe rakorderi PP-R*

Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertuesit -distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si:Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.)

Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**,konkretisht operatori ekonomik **Shendelli Shpk**, për kontratën e furnizimit datë.06.08.2016 lidhur midis paleve shoqëria **H – S shpk** dhe shoqëria **Shendelli Shpk** me objekt furnizim Rakorderi dhe tubacione te ndryshme , rezultoi se nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar,nuk ka dorëzuar çertifikatat **ISO 14001:2004, OHSAS 18001:2007 (e vlefshme)**, (ose ekuivalente), për materialet Tubo PVC,Tubo PP,Tubo PE, Tubo dhe rakorderi PP-R,gjithashtu çertifikatat e tjera **ISO 9001:2008/2015**, nuk janë në gjuhën shqipe,janë të papërkthyer dhe të panoterizuara, duke e bërë të pamundur identifikimin .

Përsa i përket specifikimeve teknike të dorëzuara nuk janë në gjuhën shqipe,janë të papërkthyer dhe të panoterizuara, duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimit të specifikimeve teknike. Operatori ekonomik Shendelli Shpk ka dorëzuar kataloge dhe specifikime teknike në *gjuhën shqipe* të cilat nuk përputhen me kërkesat e vendosura në dokumentat standarte të tenderit.

Operatori ekonomik Shendelli Shpk ka dorëzuar vetëm një çertifikatat të vlefshme **ISO 9001:2008** të shoqërisë H – S shpk .

Për kontratën e furnizimit datë.05.07.2017 lidhur midis paleve shoqëria **E..... shpk** dhe shoqëria **Shendelli Shpk** me objekt furnizim tubo plastike, rezultoi se nuk ka paraqitur dokumentacion e kërkuar,pasi nuk ka dorëzuar çertifikatat **ISO 14001:2004, OHSAS 18001:2007 (e vlefshme)**, (ose ekuivalente), për materialet Tubo PVC,Tubo PP,Tubo PE, Tubo dhe rakorderi PP-R.

Operatori ekonomik Shendelli Shpk ka dorëzuar vetëm një çertifikatat të vlefshme **ISO 9001:2015** të shoqërisë **E..... shpk**.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**,rezultoi se asnjë nga operatori ekonomik, nuk ka dorëzuar dokumentacion kualifikues për plotësimin e pikës **2.3.4 germa b,c,d,e**, duke mos plotësuar kërkesën kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit, në kundërshtim të nenit 14 , nenin 30 nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës.

Përcaktuar shprehimisht:

“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”, si dhe në dokumentat e tenderit, Seksioni 4 Procedura, pika 4.6 është përcaktuar shprehimisht: “Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip X Anglisht

Tjetër _____

9. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.5**, kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi për sa i përket kapaciteteve ne mjete dhe paisje teknike duhet të dorëzojë dokumentet sipas shtojcës nr.10.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**, konkretisht shtojcën mbi diponimin e makinerive të operatori ekonomik **Shkelqimi 07 shpk**, dhe dokumentave shoqëruese rezultoi se ka mangesi në plotësimin e kapaciteteve ne mjete dhe paisje teknike në bazë të përqindjes së punëve të marrë përsipër deklaruar në marrevëshjen e bashkëpunimit.

Nga verifikimi i shtojcës nr.10 operatori ekonomik **Shkelqimi 07 shpk**, ka deklaruar vetem 1 Autobetoniere me targe AA 187 HD,mjetet e tjera Autobetoniere të cilat nuk janë deklaruar në këtë shtojcës nuk mund te merret ne konsiderate ne kete procedure prokurimi.

Mungon dokumentacion kualifikues për mjetet, Vinc Kulle, Skela metalike (forme H) të kompletuara me parapet mbrojtës, shkallë me rretë mbrojtëse për punime në fasadë), Betonforma, Motogjenerator, Depozite Uji 5000 lit, Vibrator, Matrapik, Aparat Saldimi, Pompe Suvatimi.

Gjithashtu, mungon dokumentacion për mjetet dhe pajisje e mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: Kokore, Jelekë, Fikëse zjarri, Prozhektorë ndriçimi, Komplet i ndihmës së shpejtë, Tabela paralajmëruese për sigurinë, Karroca dore.

Referuar nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) dhe marrvëshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës bashkimi i operatorëve ekonomikë Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk nuk plotëson pikën 2.3.5 kërkesë kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit.

10. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.5, germës f**, kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi për sa i përket kapaciteteve në mjete dhe pajisje teknike duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Fabrike prodhim betoni Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

Për fabrikën e prodhimit të betonit në rast se është në pronësi të firmës, duhen të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë, leja mjedisore Kodi III I B lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, në rast se është me qera duhet të paraqitet kontrata e furnizimit, me afat të vlefshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi, QKL, planimetri dhe dokumentacion dhe vërtetohet pronësia e fabrikës. Ajo duhet të jetë jo më larg se 60 km nga sheshi i ndertimit, për të siguruar një cilësi sa më të lartë të specifikuar në markat e betonit.)

Mosparaqitja ose pavlefshmeria e ketyre dokumentave perben kusht per skualifikim.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë **Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk**, për sa i përket fabrikës së prodhimit të betonit të deklaruar nga operatori ekonomik **Shendelli Shpk**, për të cilën ka lidhur kontratë furnizimi me shoqërinë "F....." shpk, dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk e përmbush kriterin e vendosur në dokumentat standarte të tenderit konkretisht pikën **2.3.5,germa f**, në lidhje me fabrikën e prodhimit të betonit **e cila duhet të jetë jo më larg se 60 km** nga sheshi i ndertimit, sipas vendodhjes së objektit të kontratës përcaktuar në raportin teknik dhe seksioni 2.10 në dokumentat standarte të tenderit.

Nga krahasimi i vendodhjes së fabrikës me anë të cilës operatori ekonomik **Shendelli Shpk** do të furnizohet me beton dhe vendndodhjes së sheshit të ndertimit konkretisht "Shkolla e Mesme e Bashkuar "JANI VRETO", qyteti Leskovik rezulton të jetë 98.8 km nga 60 km që kërkohet, kjo referuar inventarit të rrjetit rrugor kombëtar me detajet e nevojshme (distancë, gjerësi, etj), të publikuar nga Autoriteti Rrugor Shqipëtar.

Për sa i përket fabrikës së prodhimit të betonit të deklaruar nga operatori ekonomik **Shkelqimi 07 shpk**, dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk e përmbush kriterin e vendosur në dokumentat standarte të tenderit konkretisht pikën **2.3.5,germa f**, në lidhje me fabrikën e prodhimit të betonit **e cila duhet të jetë jo më larg se 60 km** nga sheshi i ndertimit, sipas vendodhjes së objektit të kontratës përcaktuar në raportin teknik dhe seksioni 2.10 në dokumentat standarte të tenderit.

Nga krahasimi i vendodhjes së fabrikës me anë të cilës operatori ekonomik **Shendelli Shkelqimi 07 shpk** do të furnizohet me beton dhe vendndodhjes së sheshit të ndertimit konkretisht "Shkolla e Mesme e Bashkuar "JANI VRETO", qyteti Leskovik rezulton të jetë 167.2 km nga 60 km që kërkohet, kjo referuar inventarit të rrjetit rrugor kombëtar me detajet e

nevojshme(distançë,gjerësi, etj), të publikuar nga Autoriteti Rrugor Shqipëtar .

Nisur nga ky fakt dokumentacioni i paraqitur për fabrikën e prodhimit të betonit nuk plotëson kërkesën e vendosur në dokumentat standarte të tenderit.

Referuar nenit 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe marrveshjes së bashkëpunimit për zbatimin e kontratës bashkimi i operatorëve ekonomikë Shendelli Shpk dhe Shkelqimi 07 Shpk nuk plotëson **pikën 2.3.5 germa f** kërkesë kualifikuese të vendosur në dokumentat standarte të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të 46, pika 1 nenit 53, pika 3 Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe neni 66 ,neni 74 pika 3 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe fakteve të mësipërme shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë për këtë procedurën e prokurimit e shpall **të pavlefshme** ofertën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “**Shendelli Shpk**” dhe “**Shkelqimi 07 Shpk**”, pasi nuk plotëson kërkesat kualifikuese të vendosura në dokumentat standarte të tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **ALBA KONSTRUKSION SHPK** me adresë Tiranë Rr.Frederik Shiroka,Pallati i ri,Shkalla B,Kati 2 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **62,057,003 (Gjashtëdhjetëedymilione pesëdhjetëeshtatë mijë e tre) lekë pa Tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

Emri	Bashkisë Kolonjë
Adresa	Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax	+355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173
E-mail	bashkia.kolonje@gmail.com

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi , por jo me vonë se **5 (pesë) ditë** nga marrja e kërkesës me shkrim për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **28.08.2018**

Ankesa: PO

(nëse ka) ka marrë përgjigje me shkresë nr.1838/1 prot në datë.06.09.2018

Në datën 19.09.2018 autoriteti kontraktor bashkia kolonjë është njoftuar nga komisioni i prokurimit publik nëpërmjet vendimit nr.1485/1 Prot datë.17.09.2018 me objekt: “Urdhër për pezullim procedure prokurimi”, “Shqyrtimi ne themel”.

Me Vendim të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 777/2018 prot, datë,15.11.2018 protokolluar me tonën nr.2553 prot, datë.21.11.2018 është vendosur të mos pranohet ankesa e paraqitur nga

bashkimi i operatorëve ekonomik “ **Kacedja Shpk** ” dhe “ **Agri Construction Shpk** ” dhe ne si Autoritet Kontraktor, na lejohet të vazhdojme me hapat e mëtejshem të kësaj procedure.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ILIA STEFO

